



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC**

AUTORITETI KONTRAKTOR: BASHKIA ROSKOVEC

AUTORITETI KONTRAKTOR: BASHKIA ROSKOVEC

UDHËZUES PËR APLIKANTËT

**QEVERISJE E MIRË PËRMES PJESËMARRJES AKTIVE NË BASHKËFINANCIMIN E
PROJEKTEVE**

Referenca: Ligji 139/2015 'Për vetqeverisjen vendore', i ndryshuar; Ligji 9936/2008 'Për
menaxhimin e sistemit buxhetor' i ndryshuar

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit:

31/03/2026 at 16:00

TABELA E PËRMBAJTJES

1. PROJEKTE SIPAS QEVERISJES SË MIRË PËRMES PJESËMARRJES AKTIVE NË BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTEVE	
1.1.Hyrje.....	3
1.2 Objektivat e thirrjes për propozim	4
1.3 Shuma financiare e siguruar nga autoriteti kontraktorl	4
2. RREGULLAT PËR KËTË THIRRJE PËR PROPOZIME	4
2.1. Kush mund të aplikojë?	5
2.2. Procesi i aplikimit dhe kohëzgjatja e mbështetjes financiare.....	5
2.3. Kriteret e pranueshmërisë.....	5
2.4. Kriteria të papranueshme.....	6
2.5. Kostot dhe veprimet e pranueshme dhe të papranueshme	7
2.6. Procesi i aplikimit:	8
2.6.1. Ku dhe si të dërgoni aplikimet.....	9
2.6.2. Afati i fundit për paraqitjen e aplikimeve	9
2.6.3. Informacione të mëtejshme në lidhje me aplikimet	9
2.7. Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve	9
2.8. Përzgjedhja e përfituesve të mbështetjes financiare (nën-grantuesit)	10
2.8.1. Vlerësimi i kërkesave/propozimeve për mbështetje financiare:Error! Bookmark not defined.	10
2.8.2.Njoftimi i vendimit të Autoritetit Kontraktor	10
2.9. Tabela e tregueseve.....	10

3. LISTA E ANEKSEVE

1. PROJEKTE NE KUADER TE THIRRJES “QEVERISJE E MIRË PËRMES PJESËMARRJES AKTIVE NË BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTEVE”

Ky dokument ka të bëjë me thirrjen për propozimin e projekteve komunitare në kuadër të projektit “Qeverisje e mirë përmes pjesëmarrjes aktive në bashkëfinancimin e projekteve”. Këto udhëzime ofrojnë informacion në lidhje me thirrjen për projekte duke përfshirë kriteret e pranueshmërisë, procesin e dorëzimit të aplikimit, procesin e vlerësimit si dhe informacione të përgjithshme rreth projektit.

Aplikantët duhet të kenë lexuar këto udhëzime përpara se të aplikojnë për të siguruar respektimin e rregullave dhe kriterëve të thirrjes.

1.1 Hyrje

Bashkia vë në dispozicion një pjesë të financimit në kuadër të angazhimit për qeverisje të mirë, përmes pjesëmarrjes aktive në bashkëfinancimin e projekteve.

Objektivi është **të mbështesë dhe nxisë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe shoqërisë civile në identifikimin, bashkë-financimin dhe zbatimin e projekteve me interes publik**, duke përmirësuar qeverisjen vendore, transparencën dhe llogaridhënien përmes bashkëpunimit mes bashkisë dhe komunitetit.

Thirrja: Qeverisje e mirë përmes pjesëmarrjes aktive në bashkëfinancimin e projekteve”

1.2 Objektivat e kësaj thirrje për propozim

Objektivi i përgjithshëm

Të forcojë qeverisjen e mirë në nivel vendor përmes rritjes së pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe aktorëve lokalë në planifikimin, bashkëfinancimin dhe zbatimin e projekteve me interes publik.

Objektivi specifik

Të rrisë transparencën, llogaridhënien dhe bashkëpunimin ndërmjet bashkisë, shoqërisë civile dhe komunitetit, duke krijuar mekanizma funksionalë për bashkëfinancimin e projekteve dhe përfshirjen qytetare në vendimmarrje.

Rezultatet e pritshme

- i) Rritja e kapaciteteve të bashkisë dhe aktorëve lokalë për planifikimin dhe menaxhimin e projekteve të bashkëfinancuara.
- ii) Përmirësimi i përfshirjes së qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse lokale.
- iii) Zbatimi i projekteve konkrete të bashkëfinancuara që adresojnë nevoja reale të komunitetit dhe kontribuojnë në zhvillimin lokal të qëndrueshëm.

Grupet e synuara janë :

- Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) lokale
- Grupet informale të komunitetit
- Qytetarët aktivë dhe përfaqësues të komunitetit
- Të rinjtë dhe gratë si grupe me potencial për pjesëmarrje aktive si dhe djem dhe vajza romë dhe egjiptianë.
- Aktorë lokalë (biznese të vogla, iniciativa komunitare, partnerë lokalë)

Këto grupe synohen të përfshihen drejtpërdrejt në proceset e planifikimit, bashkëfinancimit dhe zbatimit të projekteve me interes publik.

1.3 Financimi i dhënë nga autoriteti kontraktor

Shuma totale indikative e vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor për këtë thirrje është 2,500,000 – 3,000,000 lekë (dy milionë e pesëqind mijë deri në tre milionë lekë).

Çdo projekt i paraqitur në kuadër të kësaj thirrjeje duhet të përputhet me kufijtë e mëposhtëm:

Shuma minimale për projektet e propozuara, e përcaktuar nga Bashkia, është 2,500,000 lekë (dy milionë e pesëqind mijë lekë).

Shuma minimale e kërkuar si bashkëfinancim: 5% e vlerës totale të projektit.

Shuma maksimale për projektet e propozuara është 3,000,000 lekë (tre milionë lekë).

Bashkëfinancimi i kërkuar nga aplikantët:

Shuma maksimale e kërkuar si bashkëfinancim: 7% e vlerës totale të projektit.

2 .RREGULLAT PËR KËTË THIRRJE PËR PROPOZIME

2.1 Kush mund të aplikojë?

Të pranueshëm për të aplikuar për këtë thirrje janë si më poshtë:

- Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) të regjistruara ligjërisht
- Grupet informale të komunitetit (në partneritet ose me mbështetje të një OSHC-je)
- Iniciativa qytetare ose grupe vullnetare lokale
- Të rinjtë dhe gratë të organizuar në grupe ose iniciativa komunitare
- Subjekte fizike/juridike të tjera lokale (biznese)

Aplikantët duhet të jenë banorë ose të ushtrojnë aktivitetin në bashkinë Roskovec si edhe të tregojnë angazhim konkret për bashkëfinancim dhe pjesëmarrje aktive në zbatimin e projektit.

2.2 Procesi i aplikimit dhe kohëzgjatja e zbatimit të projektit

Kohëzgjatja e aplikimit të projektit: 1 muaj nga data e shpalljes së thirrjes

Kohëzgjatja e zbatimit të projektit: nuk duhet të kalojë 6 muaj.

2.3 Kriteret e pranueshmërisë

Për t'u konsideruar të pranueshëm në këtë thirrje për propozime, aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

A. Kriteret për aplikantët

- Të jenë subjekte jofitimprurëse që veprojnë në interes të komunitetit
- Individ ose grupe komunitare lokale (formale ose informale)
- Subjektet fizike/juridike të jenë të regjistruara në QBK dhe të ushtrojnë aktivitet real.
- Aplikantët duhet të jenë banorë ose të ushtrojnë aktivitetin në bashkinë Roskovec si edhe të tregojnë angazhim konkret për bashkëfinancim dhe pjesëmarrje aktive në zbatimin e projektit.

B. Kriteret për projektet

- Projekti duhet të adresojë një nevojë reale të komunitetit lokal
- Të jetë në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë, transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare
- Të parashikojë bashkëfinancim (financiar ose në natyrë) nga aplikanti dhe/ose komuniteti
- Të ketë objektiva të qarta, aktivitete të matshme dhe rezultate konkrete
- Të jetë i realizueshëm brenda afatit të përcaktuar nga thirrja

C. Kriteret financiare

- Buxheti të jetë realist, i detajuar dhe i justifikuar
- Shpenzimet të lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e projektit
- Kontributi i bashkëfinancimit të jetë i qartë dhe i dokumentuar

Vetëm aplikimet që plotësojnë të gjitha kriteret e mësipërme do të kalojnë në fazën e vlerësimit.

Vendndodhja

Zbatimi I projektit duhet të shtrihet në atë zonë që i përket territorit të Bashkisë Roskovec.

2.4 Kriteria të papranueshme

Në kuadër të thirrjes **“Qeverisje e mirë përmes pjesëmarrjes aktive në bashkëfinancimin e projekteve”**, aplikantët **nuk janë të pranueshëm për pjesëmarrje në këtë thirrje** nëse ndodhen në një nga situatat e mëposhtme:

- janë në falimentim, në proces likuidimi, kanë pezulluar aktivitetin ose janë nën administrim gjyqësor, apo në procedurë të ngjashme sipas legjislacionit në fuqi;
- janë objekt i procedimeve ligjore që lidhen me situatat e mësipërme;
- janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale që lidhen me sjelljen profesionale, mashtrim, korrupsion ose veprimtari të tjera të paligjshme;
- janë fajtorë për shkelje të rënda profesionale, të provuara me çdo mjet ligjor;
- nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore në lidhje me pagesën e taksave dhe detyrimeve ndaj buxhetit të shtetit;
- kanë qenë subjekt i shkeljeve të rënda kontraktuale në procedurë të mëparshme prokurimi ose dhënieje grantesh të financuara nga fonde publike ose donatorë;

- kanë tentuar të ndikojnë në mënyrë të papërshtatshme procesin e vlerësimit, të sigurojnë informacion konfidencial ose të ushtrojnë presion ndaj strukturave vlerësuese;
- nuk respektojnë standardet ligjore për pagat, kushtet e punës dhe parimet e punës së denjë;
- janë konstatuar më parë për keqpërdorim të fondeve publike, fondeve të donatorëve ose fondeve të bashkëfinancimit;
- janë parti politike, grupime politike, institucione politike, si dhe strukturat apo degët e tyre.

Aplikantet që ndodhen në njerën prej situatave të mësipërme do të përjashtohen nga procesi i vlerësimit.

2.5 Kostot dhe veprimet e pranueshme dhe të papranueshme

Kjo thirrje synon të mbështesë dhe të nxisë pjesëmarrjen aktive të qytetareve dhe shoqërisë civile në drejtimin, bashkë-financimin dhe zbatimin e projekteve me interes publik, duke përmirësuar qeverisjen vendore, transparencën dhe llogaridhënien përmes bashkëpunimit me bashkësi dhe komunitetin.

Fondet mund të përdoren për një sërë aktivitetesh që janë në përputhje me objektivin e projektit.

- **Kostot e pranueshme**
- Blerja e lëndëve të para
- Dhurim në natyrë (fuqi puntore) ose monetare.
- Dhenia në përdorim e mjeteve të nevojshme për realizimin e projektit.

Shpenzime të papranueshme

Këto kosto janë të papërshtatshme:

- blerjet e tokës ose ndërtesave;
- kostot e pagave të personelit të administratës;
- tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH)
- borxhet dhe tarifat e shërbimit të borxhit (interesi i borxhit)
- gjobat, gjobat financiare dhe shpenzimet e procesit gjyqësor;
- tarifat e konsulentit ndërmjet përfituesve të mbështetjes financiare ndaj palëve të treta për shërbimet ose punën e kryer në kuadër të projektit;
- taksat, doganat dhe detyrimet e importit dhe taksat dhe/ose tarifat me efekt të njëjtë.

Aktiviteti i pranueshëm duhet të jetë në sektorët e mëposhtëm ekonomik:

1. Bujqësia
2. Turizëm/ Gastronomi & Mikpritje
3. Infrastruktura rrugore, ndricim, mjedis, ujë që përfiton komuniteti

Llojet e mëposhtme të veprimeve janë të papërshtatshme:

- veprimet e lidhura me partitë politike;

Përfituesit duhet të sigurojnë që mbështetja financiare të respektojë kufizimet në përshtatshmërinë e veprimeve.

2.6 Procesi i aplikimit:

Fondet do të jepen mbi baza konkurruese me një thirrje publike të shpallur nga Bashkia Roskovec si autoriteti kontraktor.

Thirrja për Propozime dhe paketa e aplikimit mund të shkarkohen në burimet e mëposhtme:

1. Bashkia Roskovec: <https://bashkiaroskovec.gov.al>

Formularët për dorëzimin e aplikimeve janë:

- 1) Formulari i aplikimit për projektin
- 2) Prezantimi i idesë së projektit
- 3) Buxheti i projektit
- 4) Deklarata e aplikantit

2.6.1 Ku dhe si të dërgohen aplikimet

Aplikimi do të dorëzohet nëpërmjet sistemit të postës ose do të dorëzohet në adresën e mëposhtme:

Bashkia Roskovec, Zyra e Protokollit

Godina e Bashkisë Roskovec

2.6.2 Afati i fundit për paraqitjen e aplikimeve

Afati i fundit për paraqitjen e aplikimeve është: **31/03/ 2026, ora 16:00**

Çdo aplikim i dorëzuar pas afatit do të refuzohet.

2.6.3 Informacione të mëtejshme rreth aplikimeve

Pyetjet mund të dërgohen me e-mail jo më vonë se 15 ditë përpara afatit për dorëzimin e aplikimeve të plota në adresat e listuara më poshtë, duke treguar qartë referencën e thirrjes për propozime: **E- mail: info@bashkiaroskovec.gov.al**

Autoriteti kontraktor nuk ka asnjë detyrim për të dhënë sqarime për pyetjet e marra pas kësaj date.

Përgjigjet do të jepen jo më vonë se 7 ditë përpara afatit të fundit për dorëzimin e aplikimeve.

Për të siguruar trajtim të barabartë të aplikantëve, autoriteti kontraktor nuk mund të japë një opinion paraprak mbi përshtatshmërinë e aplikantëve kryesorë, bashkë-aplikantëve, entiteteve të lidhura ose një veprimi.

Asnjë përgjigje individuale nuk do të jepet për pyetjet. Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet si dhe njoftimet e tjera të rëndësishme për aplikantët gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit, do të publikohen në faqen e internetit të Bashkisë Roskovec.

2.7 Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve

Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga autoriteti kontraktor dhe një perfaqesues nga komuniteti. Të gjitha aplikimet do të vlerësohen sipas hapave dhe kriterëve të mëposhtme.

Nëse shqyrtimi i aplikacionit zbulon se veprimi i propozuar nuk i plotëson kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në seksionin 2.3.1, aplikacioni do të refuzohet vetëm mbi këtë bazë

2.8 Përzgjedhja e përfituesve të thirrjes

Vlerësimi i aplikimeve/propozimeve për bashkë-financim duhet të jetë i dokumentuar mirë nga grupi vlerësues.

2.8.1 Vlerësimi i aplikimeve/propozimeve për mbështetje financiare:

Kriteret e pranueshme që aplikanti duhet të plotësojë janë:

- Aplikanti është i pranueshëm sipas kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje dhe ka lidhje të qartë me komunitetin lokal;
- Propozimi i projektit është i plotë, i paraqitur brenda afatit dhe sipas formatit të kërkuar;
- Projekti adreson një nevojë reale dhe të dokumentuar të komunitetit lokal;
- Propozimi është në përputhje me objektivat e thirrjes **“Qeverisje e mirë përmes pjesëmarrjes aktive në bashkëfinancimin e projekteve”**;
- Projekti demonstroi qartë pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe/ose aktorëve lokalë në planifikim dhe zbatim;
- Parashikohet bashkëfinancim i qartë dhe i justifikuar (financiar ose në natyrë) nga aplikanti dhe/ose komuniteti;
- Objektivat, aktivitetet, rezultatet dhe indikatorët janë të qarta, të matshme dhe realiste;
- Afati i zbatimit është i arsyeshëm dhe i realizueshëm;
- Buxheti është realist, i detajuar dhe në përputhje me aktivitetet e propozuara;
- Projekti respekton parimet e barazisë gjinore, përfshirjes sociale dhe transparencës;
- Aplikanti angazhohet të respektojë kërkesat për raportim, monitorim sipas rregullave të thirrjes.

Vetëm aplikimet që plotësojnë të gjitha kriteret e mësipërme do të kalojnë në fazën e vlerësimit cilësor dhe të pikëzimit.

HAPI 1: HAPJA DHE KONTROLLET ADMINISTRATIVE

Gjatë kontrollit [hapjes së zarfeve] administrativ do të vlerësohen sa vijon:

- Nëse është respektuar afati. Përndryshe, aplikimi do të refuzohet automatikisht.
- Nëse të katër dokumentet e kërkuara janë dorëzuar. Nëse ndonjë nga informacionet e kërkuara mungon ose është i pasaktë, aplikimi mund të refuzohet vetëm mbi këtë bazë dhe nuk do të vlerësohet më tej.

Për vlerësimin e duhur të aplikimeve/propozimeve, përfituesit e thirrjes mund të përdorin tabelën e mëposhtme të vlerësimit dhe të përfshijnë kriteret e përzgjedhjes

Aplikantët do të marrin një përgjigje që tregon numrin e referencës së aplikimit të tyre dhe rezultatet përkatëse.

HAPI 2: VLERËSIMI I APLIKIMIT TË PLOTË

Tabela e Vlerësimit

1. Kriteret operative	Rezultati maksimal
Cilësia e projekt propozimit	15
Numri i përfituesve nga zbatimi i projektit	30
Qëndrueshmëria e investimit	10
Mbështetje për grupe vulnerabël dhe grupet minoritare	20
2. Kriteret financiare	
Bashkefinancimi në zbatimin e projektit (5-7%)	25
Rezultati total	100

Nëse rezultati total (kapaciteti financiar dhe operacional) është më pak se 60 pikë, aplikimi do të refuzohet.

Përzgjedhja e përkohshme

Pas vlerësimit, do të hartohet një tabelë ku renditen aplikimet e renditura sipas pikëve të tyre. Gjithashtu, sipas të njëjtave kriteresh do të hartohet një listë rezervë.

2.8.2 Njoftimi i vendimit të Autoritetit Kontraktor

Aplikantët do të informohen me shkrim për vendimin e Autoritetit Kontraktor në lidhje me aplikimin e tyre dhe, nëse refuzohet, arsyet e vendimit negativ. Përgjigjja do të dërgohet me e-mail ose me postë.

Aplikantet e refuzuar kane te drejten e ankimit brenda 7 ditëve nga marrja e pergjigjes mbi vlerësimin e aplikimeve nga Autoriteti Kontraktor.

2.9 Kalendari orientues

	DATE	KOHA
1. Shpallja e thirrjes	2 mars 2026	11.00
2. Takimi informues I Vendi : Bashkia Roskovec	6 mars 2026	11.00
3. Takimi informues II Vendi : Ne komunitet	16 mars 2026	16:00
4. Takimi informues III Vendi : Ne komunitet	23 mars 2024	16:00
5. Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit	31 mars 2024	16:00
6. Informacion mbi [hapjen e zarfeve] kontrolltet administrative	1 prill 2024	16:00
7. Informacion mbi vlerësimin e aplikimeve	3 prill 2024	16:00
8. Njoftim për shpalljen e fitueseve	4 prill 2024	16:00
9. Nënshkrimi i kontratës	11 prill 2024	16:00

1. LISTA E ANEKSIVE

DOKUMENTET PER TE PLOTESUAR

Shtojca A: Formulari i aplikimit në formatin Word)

Shtojca B: Buxheti (format Excel)

Aneksi C: Deklarata e aplikantit

Aneksi D: NIPTI per bizneset ose OJF